



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 13.05.2023

Nr: 110

Ora: 21:45

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 60, DATË 13.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “LËVIZJA BASHKË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr. 496, datë 11.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, përfaqësuar nga z. Arlind Qori ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 60 regj., datë 13.05.2023. Në mbledhjen e datës 13.05.2023, ora 21:45, pas relativitetit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 60 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 60, datë 13.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 13.05.2023, ora 22:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvis ÇEFA - Relator

Elvin LAKO - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

Data: 10.05.2023 Nr: 88
Ora: 12:30



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 54, datë 08.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor ‘Partia Socialiste e Shqipërisë’”